



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit- Ured Ministra -Office of the Minister

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësi Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-7254
Nr. i faqeve Br. s. folije No. pages	- 27 -
Date:	18.09.2025
Prishtinë / a	

Nr:141/IX/2025

Datë:18.09.2025

Zëvendësministri i Ministrisë i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 11 dhe 16 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nëparagrafi 6.1, si dhe Kërkesës me nr. prot. 05-7102 datë 17.09.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Plani i veprimit për realizimin e projektit „Qendra e Sëmundjeve të Varësisë”.
- II. Shtojcë e këtij vendimi është Plani i veprimit për realizimin e projektit „Qendra e Sëmundjeve të Varësisë”.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Zëvendësministri i Shëndetësisë.

Dr. Arsim Berisha

Zëvendësminister i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- DPSSH;
- Departamentit ligjor
- Arkivit të MSh-së.



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health

**PLANI I VEPRIMIT
PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT
‘QENDRA E SËMUNDJEVE TË VARËSISË’**

Prishtinë, 2025

Shkurtesat

ASK	Agjencia e Statistikavetë Kosovës
BLS	Basic Life Support (Mbështetje Bazë e Jetës)
DP	Detyra Projektuese
EMK	Ekipa Menaxhues e Kontratës
ESPAD	European School Survey Project on Alcohol and Other Drugs (Projekti Evropian i Anketës Shkollore mbi Alkoolin dhe Drogat e Tjera)
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OBSH	Organizata Botërore Shëndetësore
OE	Operatori Ekonomik
PSO	Procedura Standarde Operative
PV	Plani i Veprimit
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SSSh	Strategjia Sektoriale Shëndetësore
STEPS	Stepwise approach to Surveillance (Qasje hap pas hapi për survejimin / vëzhgimin e faktorëve të rrezikut)
SWOT	Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet)
ShSKUK	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
TMM	Trajtimi Mbrojtës me Metadon
UA	Udhëzimi Administrativ
UNODC	United Nations Office on Drugs and Crime (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin)
ZKA	Zyrtra i Kryesor Administrativ

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	4
II.	HYRJA.....	5
III.	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	6
3.1	Objektivat.....	6
IV.	METODOLOGJIA	7
V.	SFONDI.....	8
5.1	Analiza SWOT	12
5.2	Funksionalizimi i Qendrës për Sëmundje të Varësisë.....	14
5.2.1	Vështirësitë dhe mundësitë	15
5.3	Bashkëpunimi ndërinstitucional.....	16
VI.	ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT.....	18
VII.	NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT	19
	PLANI I VEPRIMIT.....	20

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ministria e Shëndetësisë (MSh) e Republikës së Kosovës është aktori kryesor dhe udhëheqës strategjik në procesin e ndërtimit dhe funksionimit të Qendrës së Sëmundjeve të Varësisë. Nëpërmjet angazhimit të saj institucional, MSh siguron krijimin e një infrastrukture shëndetësore moderne dhe standarde të larta profesionale për trajtimin e sëmundjeve të varësisë.

MSh është përgjegjëse për zhvillimin e kornizës ligjore dhe rregullatorë që mbështet funksionimin e qendrës, si dhe për përcaktimin e standardeve mjekësore dhe protokolleve klinike që garantojnë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve të ofruara në qendër. Ajo gjithashtu koordinohet ngushtë me institucionet tjera qeveritare, organizatat joqeveritare dhe partnerët ndërkombëtarë për të siguruar burimet e nevojshme financiare dhe teknike.

Përveç ndërtimit fizik, MSh është përgjegjëse edhe për trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit mjekësor dhe psikologjik që do të punojë në qendër. MSh do të sigurojë që qendra të ofrojë shërbime cilësore dhe të integruara për diagnostikimin dhe trajtimin e varësive, duke kontribuar në përmirësimin e shëndetit publik dhe mirëqenies sociale në Kosovë. Ajo gjithashtu mbikëqyr implementimin e programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimin në komunitet, me qëllim parandalimin e varësive dhe reduktimin e stigmatizimit.

MSh është përgjegjëse që me ligj ta parasheh themelimin e Qendrës dhe të përcaktoj detyrat dhe përgjegjësitë për funksionimin dhe realizimin e projektit për ndërtimin e Qendrës së Sëmundjeve të Varësisë, njëherit siguron koordinimin e të gjitha fazave të projektit, duke përfshirë planifikimin, financimin, ndërtimin dhe menaxhimin e qendrës.

Projekti për ndërtimin e Qendrës së Sëmundjeve të Varësisë në Kosovë ka për qëllim krijimin e një institucioni të specializuar që do të ofrojë shërbime të avancuara për diagnostikimin, trajtimin dhe rehabilitimin e personave të prekur nga varësitë ndaj substancave psikoaktive dhe sjelljeve adiktive. Qendra do të jetë e pajisur me infrastrukturë moderne dhe teknologji të avancuar, duke përfshirë ambiente për trajtim dhe rehabilitim, laboratorë për vlerësim dhe monitorim të pacientëve, si dhe hapësira për mbështetje psikologjike dhe sociale. Personeli do të përbëhet nga mjekë specialistë, psikologë, punonjës socialë dhe staf mbështetës, të trajnuar në mënyrë multidisiplinare për ofrimin e trajtimit të integruar dhe të përshtatur ndaj nevojave individuale të pacientëve.

Ky projekt synon të ofrojë trajtime bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë terapinë medikamentozë, psikoterapinë, trajtimin e krizave, si dhe programe rehabilitimi afatgjatë. Përveç trajtimit klinik, Qendra do të zhvillojë programe edukative dhe ndërgjegjësuere për komunitetin, me qëllim parandalimin e varësisë dhe uljen e stigmatizimit të personave të prekur.

Investimi në këtë qendër pritet të sjellë përfitime afatgjata në shëndetin publik, duke reduktuar ndikimet negative sociale dhe ekonomike të varësive, si dhe duke kontribuar në forcimin e sistemit shëndetësor dhe mbështetjen sociale në Kosovë. Projekti do të zbatohet në përputhje me politikat dhe ligjet e Kosovës, si dhe me bashkëpunimin e institucioneve relevante dhe partnerët ndërkombëtarë.

II. HYRJA

MSh e Republikës së Kosovës është aktori kryesor dhe udhëheqës strategjik në procesin e ndërtimit dhe funksionimit të Qendrës së Sëmundjeve të Varësisë.

Varësia ndaj substancave psikoaktive dhe formave të tjera të varësisë paraqet një sfidë të rëndësishme për shëndetin publik dhe për sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës. Si e tillë, kërkon qasje gjithëpërfshirëse, ndër sektorialë dhe të mbështetur në praktika bashkëkohore, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat kombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor.

Në këtë kontekst, MSh ka hartuar Planin e Veprimit për ndërtimin e Qendrës së Varësisë në Kosovë, me qëllim të krijimit të një mekanizmi të strukturuar dhe funksional për trajtimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e individëve me varësi. Realizimi i këtij projekti përbën një ndër prioritetet strategjike të ministrisë në përmirësimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve institucionale në fushën e shëndetit mendor dhe shërbimeve psikosociale.

Ky plan përfshin veprimet e nevojshme në nivel institucional, teknik dhe operacional, duke përfshirë: përcaktimin e lokacionit të qendrës, hartimin e projektit ndërtimor dhe funksional, mobilizimin e burimeve financiare dhe njerëzore, si dhe krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit. Dokumenti gjithashtu identifikon afatet kohore dhe aktorët përgjegjës për secilën fazë të zbatimit, në mënyrë që të sigurohet një proces i koordinuar, efikas dhe i qëndrueshëm.

MSh është përgjegjëse që me ligj ta parasheh themelimin e Qendrës dhe të përcaktoj detyrat dhe përgjegjësitë për funksionimin dhe realizimin e projektit për ndërtimin e Qendrës së Sëmundjeve të Varësisë, njëherit siguron koordinimin e të gjitha fazave të projektit, duke përfshirë planifikimin, financimin, ndërtimin dhe menaxhimin e qendrës.

Ndërtimi i Qendrës së Sëmundjeve të Varësisë në Kosovë ka për qëllim krijimin e një institucioni të specializuar që do të ofrojë shërbime të avancuara për diagnostikimin, trajtimin dhe rehabilitimin e personave të prekur nga varësitë ndaj substancave psikoaktive dhe sjelljeve adiktive. Qendra do të jetë e pajisur me infrastrukturë moderne dhe teknologji të avancuar, duke përfshirë ambiente për trajtim dhe rehabilitim, laboratorë për vlerësim dhe monitorim të pacientëve, si dhe hapësira për mbështetje psikologjike dhe sociale. Personeli do të përbëhet nga mjekë specialistë, psikologë, punonjës socialë dhe staf mbështetës, të trajnuar në mënyrë multidisiplinare për ofrimin e trajtimit të integruar dhe të përshtatur ndaj nevojave individuale të pacientëve.

Qendra mendohet të ndërtohet në një hapësirë të përgjithshme prej rreth 4,000 m², ku ±2,000 m² do të përfshijnë ndërtesën kryesore të shërbimeve, ndërsa ±2,000 m² të tjera do të jenë të dedikuara për aktivitete terapeutike dhe rekreative në ambiente të jashtme. Kapaciteti i planifikuar i qendrës është rreth 25 shtretër për pacientë që do të trajtohen.

Plani i Veprimit paraqet një bazë të qartë dhe të detajuar për realizimin e këtij projekti me rëndësi të lartë shëndetësore dhe sociale, dhe reflekton përkushtimin institucional të MSh për avancimin e shërbimeve ndaj grupeve në nevojë dhe forcimin e sistemit të përgjithshëm të kujdesit shëndetësor në vend.

III. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i hartimit të Planit të Veprimit bazohet në vlerësimin e gjendjes, analizës së situatës në lidhje me realizimin e projektit ‘Qendra e sëmundjeve të varësisë’. Plani ka për qëllim të përcakton strategjitë dhe politikat për zhvillimin e infrastrukturës shëndetësore duke përfshirë investime në ndërtimin e kësaj qendre (përfshirë hapësirat e brendshme dhe të jashtme). Kjo do të ketë ndikim të drejtpërdrejt në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të popullatës së Kosovës në harmoni me misionin dhe vizionin e SSSH 2025 – 2030’, Vizioni “Popullatë e shëndetshme” dhe Misioni “Ofrimi i shërbimeve cilësore e të sigurta për të gjithë qytetarët e vendit”.

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, në kuadër të angazhimeve të saj për përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve të shëndetit mendor, synon ndërtimin e Qendrës për trajtimin e sëmundjeve të varësisë. Qendra e sëmundjeve të varësisë do të jetë qendër e specializuar për trajtimin, rehabilitimin dhe ri integrimin e personave që vuajnë nga sëmundjet e varësisë në Kosovë. Përmes kësaj qendre synohet përmirësimi i shëndetit mendor dhe fizik i qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve profesionale, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, si zvogëlimin e ndikimit negativ të varësive në shoqëri dhe ekonomi.

Kjo qendër do të jetë një institucion referues në nivel kombëtar, i konceptuar për të ofruar shërbime gjithëpërfshirëse për personat që vuajnë nga varësia ndaj substancave psikoaktive dhe forma të tjera të varësisë. Ajo do të funksionojë në përputhje me standardet ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), UNODC dhe praktikat më të mira të vendeve të zhvilluara në këtë fushë.

Qendra mendohet të ndërtohet në një hapësirë të përgjithshme prej rreth 4,000 m², ku ±2,000 m² do të përfshijnë ndërtesën kryesore të shërbimeve, ndërsa ±2,000 m² të tjera do të jenë të dedikuara për aktivitete terapeutike dhe rekreative në ambiente të jashtme. Kapaciteti i planifikuar i qendrës është rreth 25 shtretër për pacientë që do të trajtohen.

3.1 Objektivat

Objektivat e ndërtimit të kësaj qendre, janë:

- Të ofrojë një qasje profesionale, multidisiplinare dhe humane në trajtimin e varësisë;
- Të sigurojë shërbime të integruara për detoksifikim, trajtim psikosocial, rehabilitim dhe ri integrim në shoqëri;
- Të ofrojë mbështetje për familjarët dhe komunitetin në procesin e rikuperimit të pacientëve;
- Të plotësojë boshllëkun ekzistues në sistemin e shërbimeve për varësinë në Kosovë;
- Të kontribuojë në uljen e barrës sociale dhe shëndetësore që shkaktojnë sëmundjet e varësisë në vend.

Kjo iniciativë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi më të qëndrueshëm dhe efektiv të kujdesit shëndetësor për grupet më të ndjeshme të popullatës, duke reflektuar përkushtimin e institucioneve publike për të adresuar me seriozitet çështjet e varësisë si problem kompleks shëndetësor dhe social.

IV. METODOLOGJIA

Plani i veprimit lidhur me vlerësimin e gjendjes, analizës të situatës në lidhje me realizimin e projektit ‘Qendra e sëmundjeve të varësisë’ është hartuar duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr. 17/2024 dhe Manualin për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.

Dokumenti është hartuar duke u bazuar në vizitën studimore të realizuar në Klinikën Psikiatrike në Vrapçe në Republikën e Kroacisë gjatë vitit 2025. Po ashtu është bërë edhe vlerësimi i gjendjes aktuale dhe analiza e situatës.

Këto të dhëna do të shfrytëzohen për hapat e mëtejme në hartim të këtij plani të veprimit.

Plani i veprimit do të zbatohet për periudhën e ardhshme 2025 - 2027, përderisa projeksionet e tjera do të bëhen varësisht nga situata e realizimit të aktiviteteve të caktuara në afate kohore, përgjatë viteve pasuese.

V. SFONDI

Republika e Kosovës ka sipërfaqe prej 10.908 km². Kosova ka gjithsej 38 komuna me 1.469 vendbanime të organizuara sipas ligjeve të vendit. Sipas raportit përfundimtar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për regjistrimin e popullsisë për vitin 2024, Kosova ka 1.586.659 banorë të regjistruar, prej tyre 795,046 meshkuj dhe 791,614 femra¹.

Aktualisht në Kosovë mosha mesatare e popullsisë është 34.84 vjet, (mosha mesatare e meshkujve 34.03 dhe e femrave 35.66). Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë, rreth 50.2% e popullsisë jetojnë në zona urbane, ndërsa rreth 49.8% e popullsisë jetojnë në zona rurale.

Aktualisht në Republikën e Kosovës trajtimi i personave me varësi realizohet në kuadër të Klinikës Psikiatrike në QKUK në Prishtinë, që nënkupton që Kosova nuk ka një qendër për sëmundje të varësisë. Nevoja për një qendër të tillë të specializuar me kapacitete, është më se e nevojshme.

Për këtë arsye, në korrik 2025 u realizuar vizita studimore në Zagreb nga një grup punës të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, për të vlerësuar dhe analizuar situatën dhe për të zhvilluar një plan veprimi për realizimin e projektit 'Qendra e Sëmundjeve të Varësisë'. Gjatë kësaj vizite grupi është njoftuar me programet dhe metodat e punës së institucioneve përkatëse që merren me trajtimin e varësisë në Republikën e Kroacisë dhe janë shqyrtuar mundësitë për bashkëpunim profesional në lidhje me ndërtimin dhe funksionalizimin e Qendrës për Trajtimin e Varësisë në Republikën e Kosovës. Vëmendje e veçantë iu kushtua prezantimit të politikave kroate dhe praktikave të suksesshme në fushën e trajtimit të varësisë, shkëmbimit të informacionit mbi modelet e funksionimit institucional (duke përfshirë kornizën ligjore, strukturën organizative dhe standardet e cilësisë), konsultimit mbi zhvillimin e dokumentacionit të projektit dhe bashkëpunimit në edukimin e profesionistëve të shëndetësisë.

Në Republikën e Kosovës aktualisht nuk dihet numri i saktë i personave, edhe pse vlerësohet se rreth 30.000 përdorues aktiv të drogës janë në Kosovë, nga të cilët afërsisht 10.000 janë në kategorinë "përdorues problematikë". Si "përdorues problematikë" konsiderohen ata që përdorin substanca të tilla si narkotikët të paktën tre herë në javë ose janë të varur nga nga to². Përshtypjet janë që ekziston një rritje viteve të fundit, veçanërisht tek personat e rinj.³

Në vitin 2023, policia raportoi 293 raste përdoruesish të identifikuar, ndërsa deri në shtator të 2024 janë regjistruar edhe 171 raste të reja, me përdorues që variojnë nga 14 deri në 50 vjeç, përfshirë edhe një rast prej 13 vjeç⁴.

Megjithatë sipas të dhënave të ESPAD në vitin 2019, Kosova, krahasuar me vendet evropiane, vazhdon të jetë vendi me disponueshmërinë më të vogël të drogave. Sipas këtyre të dhënave, disponueshmëria e 'kanabisit' tek të rinjtë është 11%, dukshëm më e ulët se mesatarja e vendeve evropiane e studiuar nga ESPAD, e që është 32%.

¹ Agjencioni i Statistikave të Kosovës; Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2025-2030

² Insajderi+1

³ Strategjia Shtetërore Kundër Drogave 2024-2028; fq.7

⁴ Telegrafi

Po ashtu, 'ekstaza' sipas këtij studimi është e disponueshme 4.7% në krahasim me mesataren evropiane prej 14%. Amfetamina 2,8% në krahasim me mesataren 10%, metamfetamina 2,9% krahasuar me 8.5%, kokaina 5% krahasuar me 13%, dhe crack 3.1% krahasuar me mesataren evropiane 10% nga të intervistuarit. Me disa përjashtime të vogla, sipas këtij sondazhi, meshkujt janë më të prirur për të përdorur drogat se femrat.

Të dhënat për Kosovën tregojnë po ashtu përqindje më të vogël të fëmijëve nën moshën 13 vjeçare që kanë provuar substanca, krahasuar me mesataren evropiane p.sh. kanabisi në Kosovë 1.7% krahasuar me mesataren 2.4%. Sipas Klinikës Psikiatrike (QKUK), ka pasur rritje shqetësuese edhe në grup moshat 10–11 vjeç, dhe përdorimi i kokainës po rritet veçanërisht ndër femrat⁵.

Kosova sipas këtyre të dhënave po ashtu ka numrin më të vogël të personave që përdorin drogat e paligjshme rregullisht gjatë jetës 4.2%, krahasuar me mesataren evropiane prej 17% nga të intervistuarit.

Ndërsa sa i përket konsumimit të alkoolit, bazuar në të dhënat e hulumtimit STEPs 2019, përqindja e përdorimit të alkoolit nuk është e lartë në Kosovë, 70.6% e të anketuarve janë deklaruar se nuk kanë konsumuar alkool asnjëherë në jetën e tyre (60.4% meshkuj dhe 80.9% femra), përderisa në vitin 2011 84.4% nuk konsumonin alkool (75.5% meshkuj dhe 93.1% femra).

Nga këto të dhëna vërehet rritje e numrit të konsumuesve të alkoolit krahasuar me vitin 2011. Përqindja e të anketuarve në STEPs 2019, që kanë konsumuar alkool në 30 ditët e fundit, ka qenë 15.6% (23.6% meshkuj dhe 7.4% femra), përderisa në vitin 2011 8.4% kanë deklaruar që kanë konsumuar alkool në 30 ditët e fundit, meshkujt 14.6% dhe femrat 2.3%.

Nga rezultatet krahasuese shihet se në vitin 2019 në përgjithësi ka rritje të përdorimit të alkoolit, me theks të veçantë te femrat⁶.

Në një studim mbi adoleshentët (mosha 17–19 vjeç), rezultoi: 41 % e djemve dhe 31 % e vajzave janë duhanpirës, ndërsa 16 % djem dhe 9 % vajza janë përdorues ditorë të duhanit⁷.

Përdorimi i alkoolit në mënyrë të dëmshme ("harmful drinking") është i përhapur: rreth 39 % e vajzave dhe 43 % e djemve, sipas studimit që përdori AUDIT testin⁸.

Aktualisht, Kosova nuk ka një regjistër kombëtar për trajtimin e varësisë nga droga, por kjo është planifikuar me Strategjinë Kombëtare Kundër Drogës 2024 –2028⁹, por një numër i madh i institucioneve kompetente në Kosovë janë duke i adresuar problemet lidhura me drogat.

Ministria e Shëndetësisë ka zgjeruar qasjen e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet publike të nivelit dytësor dhe tretësor përmes ofrimit të një strategji të strukturuar të trajtimit që përdorë metadonin për të ndihmuar individët të rikuperohen nga varësia ndaj opioideve, që individët të mund të ri-integrohet sa më shpejtë që të jetë e mundur në mjedisin e tyre shoqëror dhe familjar.

⁵ Telegrafi

⁶ Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2025-2030 fq.30

⁷ PMCMDPI

⁸ PubMed

⁹ EUDA

Programi i Terapisë Mbajtëse me Metadon në vend i referohet: Udhëzimit Administrativ Nr.07/2027 për “Administrimin dhe Përdorimin e Metadonit për Programe Zëvendësuese”, Udhërrëfyesit klinik “Përdorimi i Metadonit për Trajtim Mbajtës me Opioide”, dhe Procedurës Standarde Operative “Përdorimi i Metadonit në Qendrat që trajtojnë klientët me terapi mbajtëse” (Programi TMM).

Programi i Terapisë Mbajtëse me Metadon zbatohet në:


- Shtatë (7) qendra në nivel vendi;
- Repartet psikiatrike të Spitaleve të Përgjithshme në Gjakovë, Pejë, Gjiilan dhe Prizren;
- Klinikën Psikiatrike në QKUK;
- Njësitet Shëndetësore të Burgjeve;
- Spitali Special “American Brain”;
- Ambulanca Specialistike e Psikiatrisë – Ambulancë e Psikologjisë Klinike “Qendra mediko-psikoterapike ”Labyrinth””.

Ministria e Shëndetësisë siguron produktin e metadonit për të gjitha qendrat zbatuese në vend në baza të rregullta vjetore, sipas planifikimit vjetor të qendrave zbatuese të programit. Divizionit i Shëndetit Mendor në MSh, për ti ndihmuar profesionistët shëndetësor në menaxhimin e duhur të rasteve të varura nga substanca narkotike, ka hartuar: Udhërrëfyesin Klinik “Trajtimi i Alkoolit dhe Drogave tjera”, Udhëzuesin “Parimet e Adolehencës - Trajtimi i Çrregullimeve gjatë Përdorimit të Substancave”, si dhe është në proces të hartimit të Udhërrëfyesit dhe Protokollit Klinik “Rreziku i mbi dozimit ndaj alkoolit dhe drogave tjera”.

Sa i përket shërbimeve aktuale me shtretër në Klinikën Psikiatrike në QKUK, është reparti i sëmundjeve të varësisë, shërbim i posaçëm për trajtim hospitalor për trajtimin e personave të varur nga alkooli dhe drogat tjera. Aktualisht, janë shtuar hapësirat njëherë është bërë riorganizimi i shfrytëzimit të kapaciteteve minimale ekzistuese bazuar në nevojat aktuale në Klinikën Psikiatrike në QKUK. Ky repart ofron shërbime për diagnostikimin, trajtimin e personave që abuzojnë me substanca psikoaktive, alkool ose varësi tjera si bixhoz, lojëra të fatit, etj.

Ky repart për personat e motivuar për trajtim nga varësitë, ofron edhe këto shërbime: vlerësimin psikiatrik për identifikimin e varësisë dhe çrregullimeve tjera bashkëshoqëruese; trajtimin dy (2) javor spitalor, detoksikimin e kontrolluar për substancat psikoaktive, si opioidet, kanaboidet, stimuluesit, alkooli, benzodiazepinat, etj.; analizat rutinë laboratorike, trajtimi me medikamente për menaxhimin e simptomave të tërheqjes nga varësia; psikoterapi individuale; psikoterapi grupore; kujdesi spitalor 24 orësh; edukimi psikosocial dhe këshillim për familjarët; trajtimi ambulator dhe konsulta të rregullta. Të gjitha këto shërbime ofrohen në kuadër të trajtimit akut.

Bazuar në statistikat e Klinikës Psikiatrike në QKUK, lidhur me hospitalizimet dhe ditët e mjekimit në repartin e sëmundjeve të varësisë, në vitin 2022 kishte 146 hospitalizime me 1779 ditë mjekimi, në vitin 2023 kishte 142 hospitalizime me 1435 ditë mjekimi, në vitin 2024 kishte 108 hospitalizime me 1088 ditë mjekimi dhe gjatë periudhës janar – korrik 2025 ishin 88 hospitalizime.



Graf. nr.1 - Hospitalizimet dhe ditët e mjekimit sipas viteve 2022-2024

Në kuadër të planit të veprimit përveç aktiviteteve për ndërtim të infrastrukturës, pajisjeve, personelit, etj., do të specifikohen edhe shërbimet që do të ofrohen në qendrën e sëmundjeve të varësisë si: detoksikimi, rehabilitimi, shërbimi ambulator dhe kujdesi pas trajtimit.

Një ndër modelet më të përdorura në fushën psikiatrike dhe të psikologjisë është modeli i Minesotës, një propozim ndërhyrjeje terapeutike, i projektuar për të trajtuar rastet e alkoolizmit dhe varësive të tjera e cila vazhdon të përdoret nga profesionistët e psikiatrisë si një metodë efektive për të rehabilituar individ me probleme të varësisë.

Qasja e strukturuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj trajtimit të varësisë, duke u përqendruar në trajtimin psikofizik, përmes kujdesit mjekësor, këshillimit psikologjik dhe mbështetjes me programe të shumta, ka për qëllim reduktimin e dëmit dhe rikuperimin gjatë gjithë jetës, me fokus të përfshirjes së individit, familjes dhe komunitetit.

Bazuar në vizitën studimore të realizuar në Kroaci gjatë vitit 2025, qështja e trajtimit të abuzimit me droga në Kroaci është e rregulluar përmes Ligjit për ndalimin e abuzimit me drogën, gjithashtu kanë Ligjin për mbrojtjen e personave me çrregullime mendore, si dhe kanë Strategji për alkool, droga, pirje duhani, lojëra, etj.

Shërbimet që ofronin për trajtim të pacientëve/klientëve ishin:

- Detoksikimi;
- Rehabilitimi;
- Spital ditor (në të cilin merret terapia në fillim të psikoterapisë); dhe
- Kujdesi pas trajtimit "After care" (terapia individuale, terapia grupore, terapia e dhunës në familje te rastet kur personat e alkoolizuar sulmojnë familjarët, bashkëshortet, etj.).

Spitali ditor dispononte 40 shtretër/karrige për ofrim të shërbimeve ditore për nevojat e klientëve, me hapësirë të mjaftueshme si për pacient që ndjekin trajtime të përditshme ashtu edhe për ata që vijnë sipas një orari të caktuar (që vijnë më rrallë). Po ashtu në këto institucione shërbimet ofrohen edhe online për pacient që jetojnë më larg.

Modeli i përdorur në Kroaci ishte 'Modeli Minnesota'.

Klinika Psikiatrike në Vrapçe – Kroaci:

- Sa i përket përbërjes së profesionistëve të angazhuar në trajtim ishin: Psikiatër, Psikolog, Pedagogë, Terapeut i Punës, Infermier/e, etj.;
- Përgjegjës për ofrimin e shërbimit ditor për 50 shtretër ishin 5 deri 7 mjek psikiatër;
- Në klinikë ishin të ndarë shtretërit për trajtimin e pacientëve në:
 - forenzikë,
 - burgje, dhe
 - varësi.
- Nga 95 shtretër të destinuar për trajtim e varësisë, 68 shtretër shfrytëzoheshin për sëmundje të varësisë, ndërsa 27 shtretër për kormobiditete (pacient që trajtohen nga bashkë ekzistenca e një sëmundje mendore dhe nga varësit prej substancave).
- Numri i shtretërve kalkulohej me numër të banorëve.

5.1 Analiza SWOT

Përparësitë

1. Nevoja urgjente dhe reale për shërbime të specializuara (Kosova ka një numër në rritje të individëve që vuajnë nga varësia ndaj drogës, alkoolit dhe substancave të tjera, duke krijuar nevojën për një qendër moderne dhe të specializuar për trajtim dhe rehabilitim);
2. Mbështetja e komunitetit dhe institucioneve shëndetësore (projektet e shëndetit mendor dhe trajtimit të varësisë janë në fokus të politikave shëndetësore kombëtare dhe janë prioritet për disa organizata ndërkombëtare, duke rritur mundësitë për bashkëpunim dhe fonde);
3. Trajtim multidisiplinar dhe qasje holistike (qendra do të mundësojë trajtim mjekësor, psikologjik, psikosocial dhe edukativ, duke adresuar varësinë në mënyrë gjithëpërfshirëse).
4. Ekzistenca e profesionistëve të shëndetit mendor në Kosovë (ka psikiatër, psikologë dhe punonjës socialë që mund të trajnohen për trajtimin e varësisë);
5. Rritje e vetëdijes dhe luftë kundër stigmatizimit (krijimi i qendrës do të rrisë vetëdijen për sëmundjet e varësisë dhe do të ndihmojë në reduktimin e paragjykimëve dhe stigmës që lidhen me këtë problem);
6. Kapacitet për trajtim afatgjatë dhe mbështetje post-trajtimi (mundësia për ofrimin e programeve të rehabilitimit afatgjatë dhe shërbimeve për mbështetje sociale dhe integrim në shoqëri);
7. Disponueshmëria e hapësirave të përshtatshme për rikonstrukcion (në disa qytete ekzistojnë objekte që mund të adaptohen për nevojat e qendrës);
8. Mbështetja për investime infrastrukturore nga qeveria dhe donatorë (projektet shëndetësore infrastrukturore përpos investimeve qeveritare, zakonisht përfitojnë edhe fonde të jashtme);
9. Qendra për trajtimin e sëmundjeve të varësisë mund të ndërtohet sipas standardeve moderne (mundësi për dizajn dhe ndërtim që plotësojnë nevojat e trajtimit të varësisë);
10. Akses relativisht i mirë në zona urbane (lokacione në/afër qytetit ofron akses të mirë për klientët/pacientët dhe stafin).

Dobësitë

1. Mungesa e përvojës së menaxhimit të shërbimeve të varësisë (institucionet shëndetësore në Kosovë mund të mos kenë përvojë të thelluar në menaxhimin e qendrës së specializuar për trajtimin e varësisë, duke rrezikuar efikasitetin e shërbimeve);
2. Kapacitet i kufizuar i stafit të trajnuar dhe ekspertëve (ekziston mungesë e personelit të specializuar si psikiatër, psikologë, terapistë, etj. të trajnuar për trajtimin e varësisë, gjë që mund të kufizojë cilësinë e trajtimit);
3. Rrjedhja e trurit (profesionistë të kualifikuar shpesh kërkojnë punë jashtë vendit, duke reduktuar bazën e stafit lokal);
4. Mungesa e stafit mbështetës (përveç stafit mjekësor, mungojnë kujdestarët, personat për mbështetje sociale dhe aktivitete rehabilituese);
5. Pagat dhe incentivat jo konkurruese (mund të ketë vështirësi për të mbajtur profesionistët për shkak të pagave të ulëta dhe mungesës së stimuljeve).
6. Mungesa e infrastrukturës moderne dhe teknologjike (në Kosovë, infrastruktura shëndetësore shpesh është e vjetërsuar ose jo e pajisur me teknologji të reja. Ka nevojë për investime të mëdha në infrastrukturë dhe pajisje për trajtim modern dhe të sigurt, duke përfshirë mjedise të përshtatshme për pacientët dhe stafin);
7. Kostoja e lartë e ndërtimit dhe pajisjes (ndërtimi dhe furnizimi me pajisje i një qendre moderne kërkon investime të mëdha fillestare).
8. Mungesa e hapësirave të dedikuara për shërbime specifike (hapësirat ekzistuese nuk plotësojnë standardet për trajtim, rehabilitim, apo aktivitete sociale);
9. Infrastruktura mbështetëse (transporti publik dhe siguria në zona mund të jenë të papërshtatshme për pacientët vulnerabil);
10. Vështirësitë në sigurimin e bashkëpunimit ndër sektorial (trajtimi i varësisë kërkon bashkëpunim midis institucioneve shëndetësore, sociale, policisë dhe institucioneve edukative, që mund të jetë sfidues për shkak të mungesës së koordinimit).

Mundësitë

1. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare për trajnime dhe shkëmbim ekspertize (mundësi për zhvillim profesional dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve);
2. Formimi i ekipeve multidisiplinare (integrimi i mjekëve, psikologëve, punonjësve socialë dhe terapistëve për trajtim gjithëpërfshirës);
3. Zhvillimi i programeve të rehabilitimit dhe integritit social (mundësia për të krijuar programe të ndryshme sociale, edukative, dhe punësimi që ndihmojnë në rikthimin e pacientëve në shoqëri dhe zvogëlojnë rrezikun e rikthimit në varësi);
4. Investimi në zhvillimin profesional afatgjatë: (mundësi për programet e certifikimit dhe specializimit brenda dhe jashtë vendit);
5. Angazhimi i vullnetarëve dhe stafit praktikant (mund të zgjerojë kapacitetet për shërbime dhe të forcojë ekipin);
6. Politikat dhe strategjitë qeveritare në favor të shëndetit mendor (politikat kombëtare për shëndetin mendor dhe varësinë mund të përkrahin zhvillimin e qendrës, përmes rregulloreve dhe financimeve shtetërore);

7. Mundësia e përfitimit nga projekte të bashkë financuara (bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë për ndërtim dhe pajisje të qendrës);
8. Përdorimi i teknologjive të reja për trajtim dhe monitorim (integrimi i telemjekësisë, aplikacioneve për mbështetje pacientësh dhe pajisjeve moderne mjekësore);
9. Zhvillimi i hapësirave të dedikuara për aktivitete sociale dhe sportive (përfshirja e elementëve të rehabilitimit fizik dhe social brenda qendrës);
10. Ndërtimi i një qendre model për rajonin (mundësi që kjo qendër të shërbejë si referencë për projekte të ngjashme në vendet fqinje).

Kërcënimet

1. Stigma dhe paragjykim i shoqëror (stigma kundër personave me varësi mund të pengojë pranimin e shërbimeve dhe pjesëmarrjen në trajtim, duke kufizuar efektivitetin e qendrës);
2. Ndryshimet politike dhe mungesa e përkushtimit shtetëror (ndryshimet në qeverisje ose prioritetet politike mund të çojnë në ulje të mbështetjes financiare dhe institucionale për qendrën);
3. Problemet komplekse shëndetësore dhe sociale [varësia shpesh shoqërohet me probleme të tjera shëndetësore (HIV, Hepatit, sëmundje mendore) dhe sociale (papunësi, varfëri), që kërkojnë resurse shtesë dhe bashkëpunim të gjerë];
4. ‘Burnout’ rrjedhja e profesionistëve të kualifikuar jashtë vendit dhe lodhja e stafit (humbje e stafit kryesor për shkak të emigrimit profesional, stresi i punës me pacientë të varur dhe mungesa e mbështetjes, trajnimeve dhe zhvillimit të stafit mund të ndikojë në performancë);
5. Rezistenca ndaj ndryshimit (disa punonjës mund të jenë rezistentë ndaj metodave të reja dhe trajtimeve moderne);
6. Mungesa e qëndrueshmërisë së financimit afatgjatë (nëse financimi varet kryesisht nga donatorë të huaj ose projekte afatshkurtra, ekziston rreziku i ndërprerjes së shërbimeve në mungesë të fondeve. Mungesa e fondeve të qëndrueshme mund të çojë në amortizim të shpejtë të infrastrukturës);
7. Rreziqet e sigurisë dhe mjedisit (pacientët me varësi mund të kërkojnë mbrojtje nga ndikimet negative të komunitetit ose presionet sociale, dhe siguria në qendër duhet të jetë prioritet për të shmangur incidente dhe rikthime në varësi);
8. Rreziqet nga mjedisi infrastrukturor (ndërtimi pa standarde dhe papërshtatshmëria klimatike, mund të çojnë në probleme afatgjata.
9. Pengesat burokratike dhe administrative në ndërtim dhe pajisje (proceset e ngadalta mund të vonojnë hapjen e qendrës);
10. Siguria e pacientëve dhe stafit (mungesa e sigurisë në ambientin fizik mund të sjellë incidente ose ikje/largim të pacientëve).

5.2 Funkcionalizimi i Qendrës për Sëmundje të Varësisë

Me qëllim të funksionalizimit të Qendrës për Sëmundje të Varësisë në Kosovë, planifikohet që kjo qendër të ketë ± 25 shtretër (bazuar në numrin e popullatës që ka Kosova dhe numrit të shtretërve që janë aktualisht në Klinikën Psikiatrike në QKUK).

Po ashtu për funksionalizimin e kësaj qendre është bërë edhe planifikimi i burimeve njerëzore, i cili duhet miratuar nga MSH dhe SHSKUK:

- 1 udhëheqës i qendrës (fillimisht nga Klinika Psikiatrike);
- 1 kryeshef i ekipit mjekësor (psikiatër);
- 4 mjek psikiatër;
- 1 kryeinfermier;
- 1 zyrtar për administratë;
- 1 zyrtar për arkiv;
- 1 zyrtar financiar;
- 1 zyrtar i prokurimit;
- 1 zyrtar i teknologjisë informative;
- 20 infermierë;
- 2 laborant mjekësor;
- 2 psikolog klinik;
- 1 sociolog (punëtor social);
- 1 ergoterapeut;
- 2 fizioterapeut;
- 2 kuzhinier;
- 2 servues;
- 1 depoist;
- 2 kopshtar (shtëpiak);
- 4 higjienistë;
- 4 punëtor sigurimi.

MSH, QKUK dhe Odat e Profesionistëve Shëndetësor duhet të realizojnë në vazhdimësi trajnime për të gjithë profesionistët shëndetësor, bashkëpunëtorët profesional dhe në përgjithësi stafin që punojnë dhe veprojnë brenda qendrës për sëmundje të varësisë.

Orari i punës për realizim të shërbimeve në Qendrën për Sëmundje të Varësisë do të jetë i mbuluar 7 ditë në javë /24 orë pune (tre turne nga 8 orë, ose dy turne nga 12 orë)

Me qëllim të funksionalizimit të Qendrës për Sëmundje të Varësisë, SHSKUK duhet të siguroj materialin/pajisjet mjekësore shpenzuese bazuar në UA - Nr. 06-2015 Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore. Po ashtu duhet të sigurohet servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e të gjitha pajisjeve mjekësore nga operatorët ekonomik (kompanitë) të licencuar.

Qendra për Sëmundje të Varësisë duhet të bazohet dhe të zbatoj Udhërrëfyesit Klinik dhe Protokollet Klinike konform Udhëzimit Administrativ në fuqi.

Me qëllim të funksionalizimit të Qendrës për Sëmundje të Varësisë, MSH dhe SHSKUK obligohet të planifikoj dhe siguroj kodet e nevojshme për punësimin e burimeve njerëzore.

5.2.1 Vështirësitë dhe mundësitë

Për ndërtimin dhe funksionalizimin e Qendrës për Sëmundje të Varësisë, duke marrë në konsideratë analizën SWOT: nevojat aktuale, standardet që duhet përmbushur, mungesës së fondeve të mjaftueshme për realizimin e projektit; kohëzgjatjes së lartë të procedurave të ndërtimit dhe vonesave të ndërtimit; vështirësive për sigurimin e një parcele të përshtatshme ndërtimore brenda afateve të kërkuara, në këtë kontekst mund të konsiderohet e arsyeshme që të shqyrtohen mundësi të tjera, më të zbatueshme në afat të shkurtër dhe të mesëm kohor, si:

1. Marrja me qira e një objekti ekzistues (që plotëson kushtet minimale të nevojshme dhe mund të përshtatet për qëllimin përkatës);

apo

2. Blerja e një objekti të gatshëm (që do të mundësonte përdorimin e menjëhershëm dhe zgjidhjen më të qëndrueshme të kërkesës hapësinore).

Këto mundësi duhet të analizohen në mënyrë të detajuar nga ekspertët profesional për nga aspekti ekonomik dhe financiar, funksional dhe ligjor, me qëllim që të gjendet zgjidhja më efikase, më e qëndrueshme dhe më e përballueshme për Ministrinë e Shëndetësisë.

5.3 Bashkëpunimi ndërinstitucional

Në funksion të sigurimit të shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse në Qendrën e Trajtimit të Sëmundjeve të Varësisë, është thelbësore të zhvillohet një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, SHSKUK-së dhe institucioneve të tjera relevante në nivel qendror dhe lokal. Ky bashkëpunim do të sigurojë koordinimin efektiv të veprimeve, shkëmbimin e informacionit, dhe mbështetjen institucionale për trajtimin dhe parandalimin e varësisë.

Institucionet kyçe për bashkëpunim:

- Ministria e Shëndetësisë - është përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e kornizës ligjore, drejtimin, financimin dhe mbikëqyrjen në ndërtimin e Qendrës për Trajtimin e Sëmundjeve të Varësisë;
- SHSKUK - është përgjegjëse në zbatimin e kornizës ligjore të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, njëherit është përgjegjëse për drejtimin, financimin, mbikëqyrjen dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për funksionimin e kësaj qendre;
- Ministria e Punëve të Brendshme - për trajtimin e rasteve të varësisë që lidhen me aspektet ligjore dhe sigurinë, përfshirë edhe trajtimin e personave në gjendje të rrezikshme sociale;
- Institucionet e Drejtësisë dhe Prokuroria - për koordinim lidhur me masat alternative të trajtimit për personat e përfshirë në sistemin e drejtësisë, që vuajnë nga varësia.
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - për integrimin social dhe mbështetjen sociale të pacientëve gjatë dhe pas trajtimit;
- Komunitet dhe Drejtoritë Komunale për Shëndetësi - për mbështetje në nivel lokal, ndërlidhjen me komunitetin dhe ofrimin e shërbimeve pas trajtimit.
- Organizatat Joqeveritare dhe Shoqëria Civile - për mbështetje psikosociale, trajnime, ndërgjegjësim dhe përfshirje aktive në programet e rehabilitimit;
- Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe Institucionet Arsimore dhe Kërkimore - për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe kryerjen e studimeve të nevojshme për përmirësimin e trajtimit.

Mënyrat e bashkëpunimit:

- Krijimi i Komiteti Koordinues Ndërinstitucional për planifikim, monitorim dhe vlerësim të veprimeve të Qendrës;
- Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për stafin dhe ndërlidhje e vazhdueshme në trajtimin e pacientëve;
- Ngritja e platformave të shkëmbimit të informacionit dhe raporteve për rastet e trajtuara;
- Zhvillimi i programeve të përbashkëta për parandalimin e varësisë në komunitete;
- Sigurimi i mbështetjes sociale dhe ekonomike për pacientët gjatë rikuperimit.

Ky bashkëpunim ndërinstitucional është thelbësor për të garantuar që qendra të funksionojë në mënyrë efektive, duke përmbushur misionin e saj për trajtimin e suksesshëm dhe integrimin shoqëror të personave që vuajnë nga sëmundjet e varësisë.

VI. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Institucioni udhëheqës për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit është Ministria e Shëndetësisë. Me qëllim të monitorimit të zbatimit të planit, janë hartuar matricat e monitorimit dhe raportimit për indikatorët e përcaktuara. Korniza e monitorimit përmban rezultatin, aktivitetin, indikatorin, bazën, cakun, mbledhjen e të dhënave si dhe gjendjen aktuale.

Realizimi i indikatorëve dhe aktiviteteve për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Qendrën e Sëmundjeve të Varësisë, do të mundësojnë sigurimin e të dhënave të bazuara në dëshmi lidhur me arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë dokument. Qëllimi i monitorimit është ofrimi i raporteve lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit, sipas të dhënave zyrtare, të cilat do të shërbejnë për vendime të bazuara në dëshmi për MSh-në.

Bazuar në indikatorët dhe aktivitetet e definuara në Plan të Veprimit, monitorohen sipas periudhës dhe frekuencës së përcaktuar dhe raportohen në MSh, duke siguruar që institucionet përgjegjëse të ofrojnë llogaridhënie në rast të moszbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të planifikuara.

Ky proces do të ndikoj në ndryshimin dhe plotësimin vjetor të Planit të Veprimit. Parim udhëheqës gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit është gjithë përfshirja, ku në proces të monitorimit dhe vlerësimit do të përfshihen të gjithë aktet dhe institucionet hisedarë në këtë fushë përmes shfrytëzimit të kapaciteteve institucionale, procedurave të brendshme dhe mekanizmave tjerë administrativë që lidhin dhe mundësojnë komunikimin e institucioneve shëndetësore mes vete. Në këtë proces, theksi është vënë në përdorimin e mekanizmave ekzistues për mbledhjen, agregimin, analizën dhe diseminimin e të dhënave në kuadër të Ministrisë dhe institucioneve tjera të përfshira. Ky dokument përfshin një numër të indikatorëve dhe aktiviteteve në nivele të ndryshme të zbatimit, për periudhën kohore të përcaktuar në dokument, duke shfrytëzuar burime të informatave, raportime në periudha të rregullta përmes strukturave të përcaktuara të procesit të monitorimit.

Raportimi i zbatimit të aktiviteteve, sfidave eventuale dhe rekomandimet për ndryshime, do të jenë periodike dhe me kohë. Kjo do të mundësojë adresimin në kohën e duhur nga gjetjet e raporteve, për qëllim orientimin e politikave për shërbimet e ofruara që kanë të bëjnë me Qendrën e Varësisë.

Rezultatet e pritura nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të mundësojnë edhe ofrimin e informatave kthyese efektive dhe me kohë për të gjitha grupet e interesit, ofrimin e raporteve të performancës së tyre, raportet fillestare ku janë të përcaktuara vlerat bazë të treguesve krahasuar me vlerat e pritshme dhe të dëshirueshme, raportet periodike të progresit si dhe raportet vjetore të performancës.

Vlerësimi përfundimtar i dokumentit do të ofroj të dhëna të bazuara në dëshmi të cilat do të shfrytëzohen si bazë për përcaktimin e kaheve strategjike në periudhat e ardhshme si dhe hartimin e dokumenteve tjera në vazhdimësi. Raportimi i monitorimit të progresit, zbatimit dhe arritjeve të Planit të Veprimit do t'i prezantohet të gjitha institucioneve hisedarë si dhe instancave përkatëse në baza të rregullta dhe kur është e nevojshme edhe publikut.

VII. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Zbatimi i Planit të Veprimit për funksionalizimin e Qendrës së Sëmundjeve të Varësisë, paraqet sfidë institucionale për sektorin e shëndetësisë dhe të gjitha palët e përfshira, marrë parasysh burimet njerëzore në dispozicion si dhe burimet financiare. Megjithatë, MSh në bashkëpunim me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit për arritjen e objektivave, do të angazhohet dhe do të zbatojë një kombinim masash që përfshijnë përmirësimin e politikave dhe standardeve profesionale, promovimin dhe edukimin shëndetësor si mekanizëm për avancimin e shëndetit të qytetarëve në nivel vendi, ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve shëndetësor për intervenimet e bazuara në evidencë, sigurimin e kushteve infrastrukturore dhe pajisjeve për këtë qendër.

Referuar Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2026-2028, MSh obligohet të paraqes dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2025 e tutje.

PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit për realizimin e projektit “Qendra e Sëmundjeve të Varësisë”									
Objektiva strategjike:		Indikatori (ët) për matjen e arritjes së objektivit:				Baza 2025	2026	2027	2028
Ndërtimi i Qendrës për Sëmundje të Varësisë me të gjitha parametrat dhe standardet Ndërkombëtare arkitekturore dhe mjekësore si dhe Ofrimi i shërbimeve profesionale		- Caktimi dhe sigurimi i parcelës; - Kontraktimi i OE për hartimin dhe dorëzimin e projektit Ideor dhe Zbatues; - Emërimi i EMK; - Kërkesa dhe sigurimi i lejes ndërtimore; - Përzgjedhja e OE punëkryes (objekti i ndërtuar - sipas fazave të ndërtimit); - Kontraktimi i OE për mbikëqyrjen e punimeve; - Raportimet e rregullta mbi ecurinë e punimeve; - Kompletimi i dokumentacionit për inspektim final dhe pajisja me Certifikatë (leje).				10%	20%	70%	90%
Aktiviteti 1 Hartimi i Projektit Ideor dhe zbatues (ekzekutiv-detal) për ndërtimin e objektit	Afati i zbatimit	Kostoja totale				Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2025	2026	2027	2028				
1.1 Kërkesa dhe përcaktimi i parcelës	Shtator - Tetor 2025	/	/	/	/	MSh	MSh/QKUK /Komuna	/	Caktimi i parcelës për ndërtim
1.2 Procedura e prokurimit dhe kontraktimi i operatorit ekonomik për hartimin e detyrës projektuese dhe dorëzimi i Detyrës Projektuese (DP)	Tetor - Nëntor 2025	5,000.00 €	/	/	/	MSh	MSh	/	Kontraktimi i OE për hartimin dhe dorëzimi i detyrës projektuese nga OE
1.3 Emërimi i ekipit për kontrollin dhe pranimin e detyrës projektuese (DP)	Nëntor 2025	/	/	/	/	MSh	MSh	QKUK	Ekipi i emëruar me vendim si dhe raporti i pranimit të DP
1.4 Konkursi i projektimit për kontraktimin e operatorit ekonomik për hartimin e projektit Ideor dhe Zbatues	Tetor, Nëntor, 2025	/	/	/	/	MSh	MSh/Div. Prokurimit	/	Kontraktimi i OE për hartimin e projektit Ideor dhe Zbatues

1.5 Emërimi i ekipit për menaxhimin e kontratës (EMK) dhe kontrollin e procesit të hartimit të projektit	Dhjetor 2025	/	/	/	/	MSh	ZKA	/	Emërimi i EMK me vendim
1.6 Hartimi i projektit Ideor dhe Zbatues me të gjitha fazat, duke përfshirë edhe specifikat për inventarin si dhe listën e pajisjeve mjekësore	Janar 2026 – Maj 2026	70,000.00 €	/	/	/	MSh	OE/MSh	/	Hartimi dhe dorëzimi i projektit Ideor dhe Zbatues nga OE
1.7 Pranimi i projektit Zbatues me të gjitha dokumentet përcjellëse (shqyrtimet gjeomenkanike dhe elaboratet e nevojshme) për të gjitha fazat	Qershor 2026	/	/	/	/	MSh	OE/EMK	/	Pranim / Dorëzimi i Projektit të kompletuar nga OE në 5 kopje fizike dhe 1 elektronike.
Aktiviteti 2 Adaptimi dhe Pajisja me leje ndërtimore	Afati i zbatimit	Kostoja totale				Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2025	2026	2027	2028				
2.1 Kërkesa për pajisje me leje ndërtimore	Qershor 2026	/	/	/	/	MSh	MSh/Njësia Kërkuese	QKUK	Kërkesa për leje ndërtimore
2.2 Shqyrtimi i projektit nga Komuna për leje ndërtimore	Korrik - Shtator 2026	/	10,000.00 €	/	/	MSh	Komuna	MSH/OE	Sigurimi i lejes ndërtimore
Aktiviteti 3 Realizimi i ndërtimit të objektit	Afati i zbatimit	Kostoja totale				Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2025	2026	2027	2028				
3.1 Kërkesa për inicim të procesit të prokurimit për përzgjedhjen e OE punëkryes	Tetor 2026	/	/	/	/	MSh	Njësia e kërkesës	/	Kërkesa e iniciuar
3.2 Procedura e prokurimit dhe kontraktimi i OE për ndërtimin e objektit	Tetor 2026 – Shkurt 2027	/	/	/	/	MSh	MSH/Div. Prokurimit	/	Kontrata për kryerjen e punëve me OE
3.3 Emërimi i ekipit për menaxhimin e kontratës	Shkurt 2027	/	/	/	/	MSh	MSh/ZKA	QKUK	EMK i emëruar

3.4 Realizimi i punëve ndërtimore	Shkurt 2027 - Dhjetor 2028			1,500,000.00 €	2,000,000.00 €	MSh	OE/MSh	QKUK	Objekti i ndërtuar
Aktiviteti 4 Kontraktimi i OE për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punimeve	Afati i zbatimit	Kostoja totale				Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2025	2026	2027	2028				
4.1 Kërkesa për inicim të procesit të prokurimit për përzgjedhjen e OE mbikëqyrës	Tetor 2026	/	/	/	/	MSh	Njësia e kërkesës	MSh	TeR/ Kërkesa
4.2 Procedura e prokurimit dhe kontraktimi i OE për mbikëqyrjen e punimeve	Tetor 2026 – Shkurt 2027	/	/	/	/	MSh	MSh/Div. Prokurimit	QKUK	Kontraktimi i OE
4.3 Emërimi i Menaxherit të kontratës së mbikëqyrjes	Shkurt 2027	/	/	/	/	MSh	MSh/ZKA	MSh/ Div. Prokurimit	MK i emëruar me vendim
4.4 Mbikëqyrja e punimeve	Shkurt 2027 - Dhjetor 2028	/	/	30,000.00 €	30,000.00 €	MSh	OE	MSh	Objekti i ndërtuar (raportimet në vazhdimësi)
Aktiviteti 5 Pajisja me leje shfrytëzimi	Afati i zbatimit	Kostoja totale				Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2025	2026	2027	2028				
5.1 Kompletimi i të gjitha dokumenteve dhe kërkesa për inspektim final	Janar 2029	/	/	/	/	MSh	OE/EMK	Komuna	Kërkesa në urbanizmin e Komunës
5.2 Realizimi i inspektimit final	Janar 2029	/	/	/	/	MSh	Komuna	Komuna	Raporti i Inspektimit Final
5.3 Pajisja me certifikatë përdorimi	Janar 2029	/	/	/	/	MSh	Komuna	Komuna	Certifikatë e përdorimit e lëshuar nga Komuna

Aktiviteti 6 Hapësira, pajisjet, autoambulancat dhe automjetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale				Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2025	2026	2027	2028				
6.1 Mirëmbajtja e hapësirës (klimatizimi, ventilimi, USB, gjenerator, nyjat sanitare, ngjyrosja, elektrikë, etj.)	TM1 2029	/	/	/	/	SHSKUK	Kl. Psikatrike	MSH	Mirëmbajtje e vazhdueshme
6.2 Sigurimi i produkteve, pajisjeve dhe mjeteve për diagnostikim dhe trajtim	TM1 2029	/	/	/	/	MSH / SHSKUK	Kl. Psikatrike	QKUK	Pajisjet e montuara me mjetet përcjellëse, kryesore dhe ndihmëse.
6.3 Sigurimi i pajisjeve teknologjike dhe funksionalizimi i sistemit të informimit	TM1 2029	/	/	/	/	MSH / SHSKUK	Kl. Psikatrike	QKUK / Donatorët	Të gjitha pajisjet teknologjike në dispozicion dhe funksionale
6.4 Sigurimi i materialit shpenzues mjekësor	TM1 – TM4 2029	/	/	/	/	SHSKUK	Kl. Psikatrike	MSH / Donatorët	I gjithë materiali shpenzues në dispozicion
6.5 Sigurimi i inventarit jo mjekësor (tavolina pune, karrige, dollapë, etj.)	TM1 2029	/	/	/	/	MSH / SHSKUK	Kl. Psikatrike	QKUK	Inventari jo medicinal në dispozicion dhe funksional
6.6 Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e të gjitha pajisjeve dhe mjeteve mjekësore nga operatorët ekonomik të licencuar (10% e vlerës së produktit)	TM1 – TM4 2029	/	/	/	/	SHSKUK	Kl. Psikatrike / OE	QKUK / MSH	Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt në vazhdimësi nga OE i licencuar
6.7 Autoambulanca (BLS)	TM4 2028	/	/	/	70,000.0 0 €	MSH / SHSKUK	Kl. Psikatrike	SHSKUK	1 autoambulancë (BLS)
6.8 Automjete	TM4 2028	/	/	/	100,000. 00 €	MSH / SHSKUK	Kl. Psikatrike	SHSKUK	2 vetura 1 furgon

Aktiviteti 7 Burimet Njerëzore	Afati i zbatimit	Kostoja totale ± për një vit	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
7.1 Udhëheqësi i qendrës (fillimisht nga Kl. Psikiatrike)	2029	1,485.00 € x 12 muaj = 17,820.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	1 udhëheqës psikiatër
7.2 Kryeshef i ekipit mjekësor	2029	1,463.00 € x 12 muaj = 17,556.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	1 kryeshef psikiatër
7.3 Mjek Psikiatër	2029	1,430.00 € x 12 muaj = 17,160.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	4 mjek psikiatër
7.4 Kryeinfermier	2029	814.00 € x 12 muaj = 9,768.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	1 kryeinfermier
7.5 Administrator dhe Arkiva	2029	550.00 € x 12 muaj = 6,600.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	2 zyrtar
7.6 Zyrtar financiar	2029	671.00 € x 12 muaj = 8,052.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	1 zyrtar
7.7 Zyrtar i prokurimit	2029	671.00 € x 12 muaj = 8,052.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	1 zyrtar
7.8 Zyrtar i Teknologjisë Informative	2029	671.00 € x 12 muaj = 8,052.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	1 zyrtar
7.9 Infermierë	2029	726.00 € x 12 muaj = 8,712.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	20 infermierë
7.10 Laborant Mjekësor	2029	726.00 € x 12 muaj = 8,712.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	2 laborantë mjekësor
7.11 Psikolog klinik	2029	880.00 € x 12 muaj = 10,560.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	2 psikolog klinik
7.12 Sociolog (Punëtor social)	2029	671.00 € x 12 muaj = 8,052.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	1 punëtor social
7.13 Ergoterapeut	2029	726.00 € x 12 muaj = 8,712.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	1 ergoterapeut
7.14 Fizioterapeut	2029	726.00 € x 12 muaj = 8,712.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	2 fizioterapeut
7.15 Kuzhinier dhe servuese	2029	523.60 € x 12 muaj = 6,276.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	2 kuzhiniere 2 servuese
7.16 Depoist	2029	523.60 € x 12 muaj = 6,276.00 €	BK	Kl. Psikiatrike	MSH	1 depoist

7.17	Kopshtar / Shtëpiak	2029	523.60 € x 12 muaj = 6,276.00 €	BK	Kl. Psikatrike	MSH	2 kopshtar / shtëpiak
7.18	Higjienistë	2029	402.00 € x 12 muaj = 4,824.00 €	BK	Kl. Psikatrike	MSH	4 higjienistë
7.19	Sigurimi	2029	402.00 € x 12 muaj = 4,824.00 €	BK	Kl. Psikatrike	MSH	4 punëtor sigurimi
Aktiviteti 8 ZHVP & EVM		Afati i zbatimit	Kostoja totale ± për një vit	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
8.1	Trajnimi i vazhdueshëm i mjekëve psikiatër në procedurat e trajtimit të varësisë dhe ngjashëm	2029	30,000.00 €	SHSKUK Odat Donatorët	Kl. Psikatrike	MSH Odat Donatorët	5 mjekë psikiatër të trajnuar jashtë vendit (nga 1 – 3 muaj)
8.2	Trajnimi i vazhdueshëm i infermierëve në procedurat e trajtimit të varësisë dhe ngjashëm	2029	50,000.00 €	SHSKUK Odat Donatorët	Kl. Psikatrike	MSH Odat Donatorët	20 infermier të trajnuar jashtë vendit (nga 1 – 3 muaj)
8.3	Pjesëmarrja në konferenca, simpoziume, kongrese, takime punuese, etj.	2029	15,000.00 €	SHSKUK Odat Donatorët	Kl. Psikatrike	MSH Odat Donatorët	Të gjithë mjekët, infermierët dhe bashkëpunëtorët profesional
8.4	Trajnimi i vazhdueshëm i bashkëpunëtorëve profesional (psikolog, sociolog, laborant, ergoterapeut, fizioterapeut)	2029	10,000.00 €	SHSKUK Odat Donatorët	Kl. Psikatrike	MSH Odat Donatorët	Të gjithë të trajnuar
8.5	Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mbështetës	2029	5,000.00€	SHSKUK Odat Donatorët	Kl. Psikatrike	MSH Odat Donatorët	Të gjithë të trajnuar
8.6	Adaptimi / Hartimi i Udhërrëfyesve Klinik dhe Protokolleve Klinike, përfshirë monitorimin e zbatimit	2029	15,000.00 €	MSH Donatorët	MSH / SHSKUK / Kl. Psikatrike	Odat Donatorët	Udhërrëfyesi Klinik dhe Protokollin Klinik të hartuar
8.7	Hartimi dhe monitorimi i zbatimit i PSO-së	2029	10,000.00 €	MSH Donatorët	MSH / SHSKUK / Kl. Psikatrike	Odat Donatorët	PSO e hartuar

Vlera e përafërt për ndërtimin e “**Qendrës për sëmundje të varësisë**”, mund të jetë rreth ±4,800,000.00 euro (përfshirë sigurimin e lokacionit, ndërtimin e objektit, punëtoritë, serat, hapësira gjelbëruese dhe për aktivitete tjera për personat në varësi, autoambulancat, automjetet, pajisjet, mjetet dhe inventarizimi i qendrës):

- Ndërtimi i objektit dhe rregullimi i hapësirës në tërësi = ±3,645,000.00 euro,
- Furnizimi me autoambulanca, automjete, pajisje dhe inventar = ±855,000.00 euro,
- Burimet Njerëzore përfshirë ZHVP dhe EVM = ±309,996.00 euro.

Aktivitetet		2025	2026	2027	2028	2029
1	Hartimi i projektit ideor dhe zbatues (ekzekutiv-detal) për ndërtimin e objektit	75,000.00	/	/	/	/
2	Adaptimi dhe pajisja me leje ndërtimore	/	10,000.00	/	/	/
3	Realizimi i ndërtimit të objektit	/	/	1,500,000.00	2,000,000.00	/
5	Pajisja me leje shfrytëzimi	/	/	/	/	/
4	Kontraktimi i OE për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punimeve	/	/	30,000.00	30,000.00	/
6	Hapësira, pajisjet, autoambulancat dhe automjetet • <i>Produkteve, pajisjet dhe mjetet për diagnostikim dhe trajtim, pajisjet teknologjike dhe funksionalizimi i sistemit të informimit, si dhe inventari jo mjekësor (685,000.00 euro)</i> • <i>Autoambulanca dhe automjete (170,000.00 euro)</i>	/	/	/	170,000.00	685,000.00
7	Burimet Njerëzore	/	/	/	/	174,996.00
8	ZHVP & EVM	/	/	/	/	135,000.00
TOTAL		75,000.00	10,000.00	1,530,000.00	2,200,000.00	994,996.00
		4,809,996.00 €				